REPUBLIKAE KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

GJ.A.nr.735/23

Datë: 04.09.2023

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr.06/L-054) dhe Rregullores Nr.02/2020 Për organizmin dhe veprimtarinë e brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, e bazuar në vendimin KGJK.nr.288/2021 të datës 18.10.2021, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i propozon Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, për miratim:

NDRYSHIMIN E PLANIT TË PUNËS SË GJYQTARËVE DHE ADMINISTRATËS SË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË PËR VITIN 2023

PËR:

Transferimin e përhershëm të gjyqtares **Filloreta Lekiqi** nga Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega Lipjan – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil.

Transferimin e përhershëm të gjyqtarit **Argzon Muçaj** nga Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil.

Arsyetim

Gjyqtarja Filloreta Lekiqi me datë 08 Dhjetor 2021 e në vazhdimësi ka parashtruar kërkesë për transferim në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, me arsyetimin se e njëjta jeton në qytetin e Lipjanit dhe udhëtimi i përditshëm është shumë i vështirë.

Duke marrë parasysh se po ashtu është paraqitur kërkesa për transferim nga gjyqtari Argzon Muçaj gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Kryetarja e Gjykatës ka vendosur që të propozoj transferimin e gjyqtares Filloreta Lekiqi në Degën e Lipjanit, si dhe transferimin e gjyqtarit Argzon Muçaj në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Të njëjtit do të vendosen në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil të gjykatave përkatëse dhe do të ngarkohen me lëndët me të cilët kanë qenë të ngarkuar gjyqtarët para transferimit.

Pjesa tjetër e planit të punës, mbetet e pandryshuar.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë
Albina Shabani – Rama